



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr.33, datë 14.05.2018**

**PËR**

**MIRATIMIN E QËNDRIMIT TË AKEP NË PËRFUNDIM TË KËSHILLIMIT  
PUBLIK “MBI DHËNIEN E TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT TË  
FREKUENCAVE TË BREZIT 800 MHZ (790-862 MHZ)” DHE PROPOZIMIN PËR  
MINISTRIN PËR PROCEDURËN E DHËNIES NË PËRDORIM TË TYRE**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 14.05.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Miratimin e qëndrimit të AKEP në përfundim të këshillimit publik të Dokumentit “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz)”**,
- **Propozimin për Ministrin për procedurën e dhënies në përdorim të tyre,**

**BAZA LIGJORE:**

1. Pika 10 e nenit 5, shkronja g) dhe gj) të nenit 8, pika 2 e nenit 65, neni 68, dhe neni 69 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 34/2017 “Për lirin e frekuencave të Dixhital – Dividentit” (**ligji nr. 34/2017**);
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 29.03.2017 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” (**VKM nr. 277/2017**);
4. Rregullore Nr. 30, Datë 05.12.2013, “Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave” (**Rregullore nr. 30/2013**).

## K Ë SH I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të paraqitur nga Grupi i Punës, si më poshtë:

1. Shkresat e ardhura nga sipërmarrësit:
  - a. Vodafone Albania me shkresën LEA/038/IL të datës 16.4.2018 protokolluar pranë AKEP me nr. 688/4 Prot. të datës 18.4.2018;
  - b. Albtelecom Sh.A me shkresën nr. 3551 Prot. të datës 16.4.2018 protokolluar pranë AKEP me nr. 688/3 Prot. të datës 17.4.2018;
  - c. Telekom Albania Sh.A me shkresën 2489 Prot. të datës 11.4.2018, protokolluar pranë AKEP me nr. 688/2 prot. të datës 12.4.2018;
2. Projektvendimi për “Miratimin e përfundimit të këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave të brezit 800 MHz (790-862 MHz)” dhe propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të tyre.”;
3. Propozimi për Ministrin për vazhdimin e procedurës i hartuar nga Grupi i Punës në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore për këtë qëllim;
5. Qëndrimin e AKEP mbi komentet e palëve të interesuara në këtë këshillim dhe publikimi i tyre;
4. Relacioni shoqërues mbi projektvendimin;
5. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

### V Ë R E N se:

1. Pas administrimit dhe marrjes në shqyrtim të materialeve:
  - Shkresa e Autoritetit të Mediave Audiovizive me nr. 674 Prot. datë 7.2.2018 “Për lirimin e brezit të frekuencave të Dixhital – Dividentit (DD1),
  - Shkresa e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 3053/1Prot. datë 15.02.2018 “Për fillimin e procesit të këshillimit publik për frekuencat në brezin 800MHz (792-860MHz), subjekt i mundshëm i të drejtave të kufizuara”, AKEP, me Vendimin nr. 10, datë 15.02.2018, të Këshillit Drejtues, ka miratuar për këshillim publik dokumentin “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz)”.
2. Procedura e këshillimit publik ka filluar më datë 16.02.2017 dhe ka përfunduar më datë 16.04.2018.
3. Pas përfundimit të këtij afati, AKEP ka administruar komentet e depozituara nga palët e interesuara, sipërmarrësit e komunikimeve elektronike Albtelecom sh.a., Vodafone Albania sh.a. dhe Telekom Albania sh.a., të cilët u janë përgjigjur pyetjeve të ngritura nga AKEP, si dhe kanë ngritur çështje të tjera, mbi dokumentin e publikuar për konsultim.
4. Qëllimi i këtij këshillimi publik dhe marrja e mendimit të palëve të interesuara mbi dhënien në përdorim e këtyre frekuencave 800 MHz, i shërbeu procesit duke krijuar një kuptim më të qartë për: 1. impaktin që do të ketë dhënia në përdorim e këtyre brezave; 2. interesit për marrjen në përdorim të tyre (numrin e kërkesave), dhe 3. njohjen me çmimin që janë të gatshëm të ofrojnë të interesuarit për këtë brez frekuencash, gjithashtu edhe me njohjen me çështje të tjera që mund të ngrihen nga të interesuarit.
5. Komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimi i AKEP mbi këto komente janë paraqitur në materialin “Qëndrimi i AKEP mbi komentet e palëve të interesuara në këtë këshillim publik”.
6. Në përfundim të procesit të këshillimit publik, analizimit dhe vlerësimit të komenteve të sjella nga palët, si dhe në përmbushje të detyrimeve të nenit 68, të

ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar, AKEP, ka përgatitur propozimin për Ministrin, në lidhje me procedurën e tenderit publik për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz)”.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918/2008, si dhe në zbatim të nenit 68 të ligjit nr 9918/2008 dhe pikës 1 të nenit 9 të ligjit nr. 34/2017, duke çmuar rëndësinë e procesit, interesin publik dhe përputhshmërinë ligjore,

### **V E N D O S:**

1. Të miratojë dokumentin me qëndrimin e AKEP ne përfundim te këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz)”, dhe të publikojë mendimet dhe komentet e palëve të interesuara, duke respektuar konfidencialitetin e informacionit, si dhe qëndrimin e AKEP për çështjet e ngritura sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Të miratojë propozimin për Ministrin për procedurën e dhënies në përdorim të frekuencave në brezin 800 MHz (790-862 MHz), sipas dokumentit bashkëlidhur;
3. Të njoftohen palët e interesuara për këtë vendim.
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Ilir ZELA**

### **ANËTARË:**

1. **Alban KARAPICI**
2. **Edlira DVORANI**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

## **DOKUMENT PËRFUNDIMTAR**

**Komentet e konsultimit publik dhe qëndrimi i AKEP**

**“Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit  
të frekuencave të brezit 800 MHz (790-862 MHz)”**

Miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr.33 datë 14.05.2018

Maj 2018

## I. Komentet e konsultimit publik dhe qëndrimi i AKEP

Në zbatim të shkronjës g) dhe gj) të nenit 8, të nenit 65, të nenit 68, të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.10, për “Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz)”, datë 16.01.2017, AKEP kreu një këshillim publik me palët e interesuara.

Në përfundim të këtij këshillimi publik, i cili filloi më datë 16.02.2018, dhe përfundoi më datë 16.04.2018, në AKEP u depozituan komentet nga palët e interesuara:

- Operatori A
- Operatori B
- Operatori C

Komentet e të interesuarve dhe qëndrimi përkatës i AKEP, paraqiten si vijon:

### i. Mënyra e ndarjes së spektrit

Për mënyrën e shfrytëzimit të brezit 790-862 MHz duhet konsideruar:

- Sasia e spektrit për bllok
- Guard band
- Gap.

Ka disa teknologji që mund të aplikohen në brezin 800 MHz si HSPA, LTE etj dhe këto teknologji kërkojnë madhësi kerrierash të ndryshme.

Duke qenë se teknologjitë “Next Generation” si LTE aplikojnë për konfigurimin e sistemeve një minimum gjerësi brezi prej 5 MHz rekomandojmë të aplikohet ndarja e mëposhtme:

790-791	791-796	796-801	801-806	806-811	811-816	816-821	821-832	832-837	837-842	842-847	847-852	852-857	857-862
Guard band	Downlink						Duplex gap	Uplink					
1 MHz	30 MHz ( 6 blloqe 5 MHz)						11 MHz	30 MHz ( 6 blloqe 5 MHz)					

AKEP, bazuar në ndarjen e mësipërme si dhe karakteristikat teknike të sistemeve LTE, kishte propozuar që numri minimal i të drejtave të përdorimit i mjaftueshëm dhe i duhur për ngritjen e sistemeve LTE në këto breza është 2 (dy) të drejta dmth 2x2x5 MHz ose ndryshe 2x10 MHz sëbashku.

### 1- Për pyetjen 1 të AKEP:

#### *Mënyra e ndarjes së spektrit*

#### *Operatori A*

Operatori A shprehet se, mbështet qëllimin për të përdorur brezin e harmonizuar CEPT me gjashtë blloqe me 2x5 MHz si reverse duplex me 1 MHz guard band (790-791 MHz), gjashtë blloqe 2x5 MHz për downlink (791-821), 11 MHz duplex gap (821-832 MHz) dhe gjashtë blloqe 2x5 MHz për uplink (832-862 MHz).

Kjo garanton madhësinë minimale të bllokut 5 MHz që është e detyrueshme për përdorimin e spektrit për teknologjinë LTE dhe lejon mënyrën e operimit FDD, e cila është me më shumë interes nga perspektiva e teknologjisë.

Operatori A shprehet se, për një operator në përgjithësi, ndarja 2x2x5 MHz ose 2x10 MHz është një numër minimal i duhur dhe i mjaftueshëm të drejtash përdorimi në brezin 800 MHz. Megjithatë, për shkak të vlerës së kufizuar të spektrit 800 MHz është shumë e rëndësishme për procedurën e alokimit për të vendosur të drejtën e përdorimit të spektrit të lejuar (kapaciteti i spektrit), i cili mund të jetë edhe 2 x 10 MHz. Kjo do të rrisë shanset për të gjithë blerësit të kenë mundësinë të blejnë pjesë të këtij spektri, i cili do të sigurojë një treg shumë konkurrues dhe një efikasitet të lartë në përdorimin e spektrit, duke shmangur situatat kur një blerës krijon dominancë për shkak të zotërimeve të panevojshme të spektrit. Nga prespektiva dhe interesi i klientit, ajo do të rrisë zgjedhjen e ofertave, veçanërisht në zonat rurale ku shërbimet e brezit kryesor do të ofrohen duke përdorur këtë spektër.

### ***Operatori B***

Lidhur me mënyrën e ndarjes së spektrit Operatori B shprehet dakord për ndarjen në minimumin e të drejtës prej 2x5 MHz. Operatori B shprehet se, në mënyrë që investimi në këtë teknologji të mund të justifikohet, të jetë eficient si dhe për një planifikim sa më racional dhe të qëndrueshëm në kohë, shprehet dakord për mjaftueshmërinë e dy të drejtave 2x2x5MHz ose ndryshe 2x10 MHz (duplex).

### **Qëndrimi i AKEP:**

*Operatorët janë dakord me propozimin e AKEP për ndarjen e spektrit ku numri minimal i të drejtave të përdorimit i mjaftueshëm dhe i duhur për ngritjen e sistemeve LTE në këto breza është 2 (dy) të drejta dmth 2x2x5 MHz ose ndryshe 1x10 MHz i çiftuar*

### ***2- Për pyetjen 2 të AKEP:***

***Bazuar mbi këtë propozim cila është vlera që jeni gati të paguani për të drejtë përdorimi 2x5 MHz?***


Operatori A

Operatori A shprehet se, vlera e spektrit varet nga shërbimet që mund të ofrohen nga përdorimi i tij, nga kushtet ekonomike aktuale të tregut të telefonisë së lëvizshme si dhe nga

pritsmëritë e kompanive në lidhje me zhvillimet e ardhshme në treg dhe fitimi përkatës, por gjithmonë, në respekt të parimit të mosdiskriminimit dhe konkurrencës së ndershme në të cilën duhet të vihen operatorët në treg.


Siç evidentohet edhe në dokumentin përfundimtar të AKEP për analizën e tregut në Shkurt 2018, tregu i komunikimeve elektronike karakterizohet nga rënia e fitimit neto dhe normat e fitimit nga operatorët kryesorë të komunikimeve elektronike. Të ardhurat totale nga shërbimet e rrjetit të lëvizshëm tregojnë një rënie nisur nga periudha 2010 -2013 dhe një trend të qëndrueshëm gjatë dy viteve të fundit 2015 -2016. Në 2016 të ardhurat totale ishin 33.9 miliardë Lekë që do të thotë një rritje e lehtë prej 2% krahasuar me vitin 2015 (shikoni më poshtë).

Edhe pse ka pësuar një rritje të lehtë të të ardhurave në tregun e komunikimeve elektronike, niveli i rritjes është i pakonsiderueshëm, gjë që tregon ekzistencë të amullisë në treg.



Siç tregohet në figurën më poshtë, fitimi neto në total i operatorëve të telefonisë celulare u zvogëluar ndjeshëm gjatë vitit 2011, 2013-2015. Në vitin 2015, rezultati total i sektorit të komunikimeve elektronike ishte negative, me një rënie të ndjeshme të fitimit të Vodafone dhe Telekom Albania në vitin 2015, përkatësisht 84% dhe 78%. Rënia e ndjeshme e fitimit të Vodafone dhe TA u pasua nga rënia e normave të fitimit të të dy operatorëve. Në vitin 2016 ka vazhduar ulja e ndjeshme e fitimeve për Telekom Albania dhe Vodafone Albania, siç tregohet më poshtë në figurë.





Trendi në ulje i të ardhurave dhe fitimeve në sektorin e komunikimeve elektronike (I reflektuar edhe në tendencën në rënie të ARPU dhe ARPM e cila ka vazhduar edhe në 2016) ndikon në konkurrencën afatgjatë dhe kapacitetin e operatorëve në sektorin e investimeve (për fshirë këtu liçencat e reja për përdorimin e spektrit), karakterizuar nga zhvillimet e teknologjisë dinamike dhe investimet e nivelit të lartë.

Siç u përmend më lart, vlera ekonomike e spektrit përfitohet nga përfitimet e rrjetit të një operatori dhe ato që ofruesi i shërbimeve mund të marrë nga ofrimi i shërbimeve me vlerë të shtuar dhe aplikacioneve, duke përdorur ekskluzivisht këto frekuenca.

Çmimi i prituri i shitjes që përcaktohet nga AKEP është konsiderueshëm mbi nivelin e çdo çmimi të arritur në tenderat e mëparshëm në vendet e rajonit me mjedis ekonomik të krahasueshëm. Duke pasur parasysh zhvillimet më të fundit në tregun shqiptar, çmimi final i shitjes i arritur në tenderin që do të zhvillohet duhet t'i lejojë operatorët të shtrijnë rrjetin në brezat përkatës. Nëse nuk do të ishte ky rasti, operatorët nuk do të kishin mundësi të marrin pjesë në tender, gjë që do të gjeneronte zero të ardhura për Rregullatorin. Në këtë aspekt, ne presim që çmimi final i shitjes të jetë shumë poshtë nivelit të çmimeve të mëparshme.

Bazuar në zhvillimet e elaboruara më lart, si dhe referuar benchmark-ut ndërkombëtar, Operatori A mendon se oferta duhet të jetë edhe më poshtë sesa vlera që Operatori A ka propozuar në përgjigjen e tij gjatë konsultimit publik të vitit 2017, e cila ishte XXXXXX Euro për çdo të drejtë përdorimi për bllok spektri 2x5 MHz.



## **Operatori B**

Operatori B sugjeron se, duke marrë në konsideratë specifikat e brezit (800 MHz) për efikasitet më të mirë për mbulim më të gjerë edhe në zona rurale dhe me reliev / terren të thyer, si dhe duke konsideruar gjithashtu edhe faktin se politikat e qeverisë që kanë për qëllim përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve me brez të gjerë në këto zona, destinacioni kryesor në përdorimin e kësaj bande do të jetë përmirësimi i mbulimit me shërbim data (broadband) në këto zona. Prandaj është më se e arsyeshme që të drejtat e përdorimit të jepen pa pagesë.

Kjo edhe për arsye se operatorët duhet të bëjnë investime të shumta, ndërkohë që është fakt që të ardhurat që sigurohen nga këto zona janë të ulëta dhe nuk arrijnë të justifikojnë investimet e nevojshme. Kthimi nga investimi i nevojshëm në këto zona nuk arrihet asnjëherë, ndërkohë që operatorët janë akoma në periudhë investimi dhe optimizimi për zgjerimin e mbulimit të ofrimit të shërbimeve LTE në brezat e tjerë si 1800 apo 2600 për të cilat operatorët kanë paguar tashmë një vlerë të konsiderueshme nga tenderimi dhe paguajnë në vazhdim rregullisht pagesën vjetore jo pak të konsiderueshme për përdorimin e frekuencave.

Megjithatë, në çdo rast që sugjerimi i Operatori B për dhënien pa pagesë të të drejtave të përdorimit në brezin 800 MHz nuk do të merret në konsideratë, Operatori B shprehet se pagesa për dhënien e këtyre të drejtave duhet të jetë minimale deri në masëm që të mbulojë vetëm kostot administrative të nevojshme për të gjithë procesin administrativ të alokimit (dhënies) të frekuencave të këtij brezi për operatorët e telefonisë së lëvizshme. Operatori B shprehet se vlera që janë gati të paguajnë për të drejtë përdorimi nuk mund të jetë më shumë se XXXXX Euro për 2x5 MHz, apo XXXXX Euro për 2x10 MHz. Lituania si vend i njohur për incentivat për zhvillimin e dixhitalizimit dhe broadband-it, e cila ka dhënë në përdorim brezin e këtyre frekuencave me cmimin më të ulët nga të gjithë vendet e Europës.

### **Qëndrimi i AKEP:**

*AKEP në përlogaritjen e çmimit minimal do të vlerësojë propozimet e paraqitura nga sipërmarrësit në këtë këshillim, praktikën e mëparshme në Shqipëri, kushtet aktuale dhe të pritshme të tregut në Shqipëri, eksperiencat dhe benchmark-un për alokimin e këtij brezi në vende të tjera përfshirë rajonin duke marrë në konsideratë specifikat e vendeve në lidhje me faktore që ndikojnë në çmimin për MHz, etj.*

### **3- Për pyetjen 3 të AKEP:**

#### **Procedura e konkurrimit publik**

*Për përzgjedhjen e fituesve do të aplikohet procedura e tenderit publik, "Procedurë e hapur", përcaktuar në Vendimin Nr.1252, datë 10.09.2008 "Për miratimin e rregullave të*

*zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar.*

### **Operatori A**

Operatori A shprehet se, synimi për të dhënë në përdorim spektrin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz) në një procedurë, është mëse i mirëpritur. "Procedura e hapur" ka qënë procesi i ndjekur deri më tani dhe Operatori A e mbështet plotësisht atë.

Është e rëndësishme të theksojmë se Spektri duhet të alokohet sipas neutralitetit të teknologjisë dhe shërbimit, që ndjek rregulloret standarte të BE për spektrin celular broadband dhe kuadrin rregullator në Shqipëri.

### **Operatori B**

Operatori B shprehet se, duke iu referuar qëndrimit për dhënien pa pagesë të të drejtave të përdorimit të frekuencave në brezin 800 MHz, nuk do të ishte e nevojshme “Procedura e hapur” sipas Vendimit nr. 1252, datë 10.9.2008, por AKEP të aplikojë thjesht “Procedurë alokimi” për të cilën kërkohet VKM i posaçëm bazuar në kushtet, rrethanat dhe qëllimin për shfrytëzimin e brezit 800 MHz.

Në rast se për sa më sipër nuk pranohet, dhe AKEP do të vijojë me procedurën e hapur sipas parashikimeve të VKM nr. 1252, datë 10.09.2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave” i ndryshuar, atëherë të garantohet si më poshtë:

- Në çdo rast duhet të implementohet në procedurën e tenderimit/eve kufizimi i numrit të të drejtave jo më shumë se 2x10 MHz, pavarësisht numrit të të drejtave të ofertuar dhe pavarësisht numrit të pjesëmarrësve. Të garantohet që një operatori të mos i jepen më shumë se dy të drejta nga 2x5 MHz ose në total 2x10 MHz dhe operatori që arrin të përfitojë në total 2x10 Mhz nga ky process tenderimi të mos ketë të drejtë të marrë më pjesë në asnjë proces tjetër tenderimi të mundshëm për këtë brez frekuencash, në mënyrë që të mos i krijohet mundësia asnjërit nga operatorët dominant të monopolizojë brezin 800 MHz si burim i fundëm shumë i rëndësishëm për zhvillimin e mbulimit me shërbime broadband dhe nxitjen e një konkurrence të shëndetshme në treg.
- Në çdo kohë të garantohet sasia e mjaftueshme dhe e barabartë për secilin nga tre operatorët në tregun shqiptar duke siguruar kështu mjedisin e duhur të konkurrencës së drejtë dhe të ndershme për të zhvilluar produktet dhe shërbimet e tyre mbi këtë brez, duke konkurruar në kushte të barabarta.

### **Qëndrimi i AKEP:**

AKEP do të vijojë procesin me procedurën e propozuar në këtë këshillim “Procedurë e hapur” bazuar në përcaktimet e pikës 1, nënpika 1.2 e VKM nr. 1252, datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave” i ndryshuar.

#### **4- Për pyetjen 4 të AKEP:**

AKEP për dhënien e të drejtave të përdorimit në këto breza do të aplikojë “Metodën e vlerësimit me raunde”, aplikuar edhe në procedurat e mëparshme. Kjo metodë vlerësimi aplikohet për të krijuar mundësinë e pjesëmarrjes në tender të sa më shumë kandidatëve si dhe për të bërë të mundur alokimin e të gjithë sasisë së spektrit brenda kësaj procedure, nëse do të ketë kërkesa.

#### **Operatori A**

Propozon ndjekjen e praktikave dhe përvajave më të mira dhe parimet udhëzuese të BE. Mbi këto baza, propozon që procesi i alokimit duhet të implementohet si një procedurë tenderi transparente, e hapur dhe jo-diskriminuese. Fleksibiliteti dhe efikasiteti i procesit mund të arrihet nga rritja simultane e ofertës (p.sh. SMRA). Për këtë është e rëndësishme që të parashikohet një procedure parakualifikuese, në mënyrë që të sigurohemi se nuk do marrë pjesë asnjë aktor i pakualifikuar apo jostrategjik. Përveç kësaj, tërheqja e ofertave duhet të ndalohet apo dënohet. Ofertat përfundimtare duhet të jenë detyruese.

#### **Operatori B**

Lidhur me këtë pikë, Operatori B shprehet se se nuk është i nevojshëm zhvillimi i procesit sipas metodës së vlerësimit me raunde, por i gjithë spektri i disponueshëm t’u alokohet në mënyrë të barabartë operatorëve të tregut.

Nëse si më lart kërkuar nuk konsiderohet, Operatori B pranon metodën e vlerësimit me raunde aplikuar edhe në procedura të mëparshme por duke garantuar që një operatori të mos i jepen me shumë se dy të drejta nga 2x5 MHz ose në total 2x10 Mhz dhe operatori që arrin të përfitojë në total 2x10 MHz nga ky proces tenderimi të mos ketë të drejtë të marrë më pjesë në asnjë proces tjetër tenderimi të mundshëm për këtë brez frekuencash, në mënyrë që të mos i krijohet mundësia asnjë operatori dominant të monopolizojë brezin 800 MHz si burim i fundëm shumë i rëndësishëm për zhvillimin e mbulimit me shërbime broadband dhe nxitjen e një konkurrence të shëndetshme në treg.

#### **Qëndrimi i AKEP:**

AKEP do të vlerësojë propozimet e operatorëve, në lidhje me procedurën e propozuar duke konsideruar se, procedura me raunde e ndjekur në praktikë mëparshme ka rezultuar e suksesshme.

## **5- Për pyetjen 5 të AKEP:**

### ***Kushtet për mbulimin me shërbim në shkallë gjeografike***

*AKEP propozon që kushtet e mbulimit me shërbime broadband në shkallë gjeografike të krahasohen me eksperincat e ngjashme në vendet europiane; jo më pak se 25 % e territorit në 6 muajt e parë të përdorimit të frekuencave.*

### ***Operatori A***

Operatori A shprehet se, në përgjithësi, objektivi i mbulimit të paktën me 25% brenda 6 muajve pas fillimit të përdorimit të spektrit duket i përshtatshëm në rastin e spektrit 800 MHz.

Megjithatë, ajo duhet të lidhet me kohën kur do të fillojë përdorimi i brezit të frekuencave 800 MHz. Përdorimi celular broadband i spektrit 800MHz duhet të lidhet me kohën kur ky spektër do të lirohet nga përdorimi i transmetimeve dhe të bëhet i disponueshëm.

Përveç kësaj, ne e konsiderojmë të papranueshme në rast se operatorët detyrohen të fillojnë menjëherë operimin brenda vitit 2017. Duke qënë se viti i ri financiar ka filluar tashmë, operatorët mund të mos kenë një buxhet të planifikuar për lancimin dhe vënien në punë të spektrit 800 MHz në vitin 2017.

Për këtë arsye, ne propozojmë të shtrijmë përmbushjen e mbulimit të synuar në 25% të territorit “gjatë vitit të parë (1) të përdorimit të frekuencave”.

### ***Operatori B***

Operatori B propozon të mos vihen detyrime për këtë brez në lidhje me kohën e implementimit dhe mbulimin e territorit. Kjo kërkesë nuk është e arsyeshme dhe e justifikueshme, pasi aktualisht operatorëve i’u janë përcaktuar tashmë detyrime të posaçme pikërisht për kushtet e mbulimit me shërbime broadband për zona me dendësi të ulët popullore (pra zona kryesisht rurale) etj., dhe këto detyrime i kemi tashmë referuar mbulimit të territorit në teknologjinë LTE dhe të tjera. Operatori B shprehet se, është e pajustificueshme që për çdo brez frekuence që merret të vendosen kushte të mbulimit ndërkohë që detyrimet për mbulimin janë tashmë të vendosura në brezat e tjerë të frekuencave për shërbime të së njëjtës natyrë (broadband) LTE apo 4G.

### **Qëndrimi i AKEP:**

*Vendosja në përdorim e frekuencave të brezit 800 MHz (790-862 MHz) dhe përqindja e mbulimit dhe koha e propozuar nga AKEP, do të justifikojë qëllimin e dhënies së këtyre frekuencave nga AKEP me Autorizim Individual. AKEP do të vlerësonte shumë qëndrimin e*

operatorëve nëse do ti ishin referuar edhe zonave të mbulimit me shërbim, ku AKEP do të preferente që operatorët të shpreheshin në përqindje mbulimi fillimisht për zonat pa mbulim me shërbimet 4G (psh zonat rurale, zonat turistike, etj) ose ato me mbulim jo të mirë me shërbime 4G.

Gjithashtu, mbulimi me shërbime broadband në shkallë gjeografike 25 % e territorit në 6 muajt e parë të përdorimit të frekuencave të brezit 800 MHz, është plotësisht i mundur pasi teknikisht këto frekuenca garantojnë një mbulim më të mirë se brezat e tjerë të caktuara nga AKEP për shërbimet 4G.

## **6- Për pyetjen 6 të AKEP:**

### **Kohëzgjatja e vlefshmërisë së Autorizimit**

*AKEP mendon që kohëzgjatja e vlefshmërisë së autorizimit të lëshuar të jetë 15 vjet.*

### **Operatori A**

Operatori A e di që kohëzgjatja e vlefshmërisë së Autorizimit (prej 15 vjetësh) është në zbatim të Ligjit të Komunikimeve Elektronike në Shqipëri.

Megjithatë, Operatori A bën një referencë ndaj pjesës së spektrit në Rishikimin në proces të Rregullores Europiane të Telekomunikimeve. Ajo bazohet në propozimin fillestar të Komisionit Europian (KE) për një kohëzgjatje minimale të licensës prej 25 vitesh, si benchmark për rregulloret e ardhshme për spektrin në Europë. Në zgjidhjen që u arrit në Shkurt mes KE-së, Parlamentit Europian dhe Këshillit të Ministrave Europiane, u ra dakort për një kohëzgjatje minimale të harmonizuar prej 20 vitesh (ose ku nuk ushtrohej në një hap të vetëm, më pak se 20 vjet plus një zgjatje kohe përkatëse) (shiko më poshtë nenin 49 formulimin për Kodin Europian të Komunikimeve elektronike EECC). Kjo merr në konsideratë investime të mëdha në infrastrukturë të cilat nevojiten për të mbuluar vendin me teknologji moderne celulare me brez të gjerë dhe u lejon klientëve nga biznesi dhe individëve në gjithë vendin të përfitojnë akses të shpejtë në internet nga aparatet celulare. Prandaj, AKEP duhet të eksplorojë të gjitha mundësitë për zgjatjen e periudhës së parashikuar të licensës nga 15 vjet në 20 vjet ose të shtojë një zgjatje të garantuar prej 5 vjetësh pas përfundimit të periudhës së parë, si pjesë e kushteve të licensës.

Në rast se AKEP parashikon një periudhë 15-vjeçare në kushtet e licensës së ardhshme për brezin 800 MHz, Operatori A është e mendimit që AKEP të shtojë një kohëzgjatje shtesë 5-vjeçare si pjesë e kushteve të licensës së ardhshme për brezin 800 MHz, siç është parashikuar në formulimin e Nenit 49 pika 2 të draftit të Kodit Europian të Komunikimeve Elektronike EECC, si më poshtë.

“2. Vendet Anëtare që alokojnë të drejta individuale për përdorimin e radio spektrit për të cilin kushtet teknike janë harmonizuar për të mundësuar përdorimin e shërbimeve të komunikimit elektronik me brez të gjerë pa tel për një periudhë kohe të kufizuar, duhet të garantojnë parashikueshmërinë rregullatore për titullarët e të të drejtave për një periudhë prej të paktën 20 vjetësh, lidhur me kushtet e investimit në infrastrukturë, që mbështet në

përdorimin e këtij radio spektri, duke marrë parasysh kërkesat në paragrafin (1). Ky nen është object amendimesh, aty ku shikohet e nevojshme, të kushteve të bashkangjitura këtyre të drejtave të përdorimit, në përputhje me nenin 18. Për këtë qëllim, ata do të garantojnë se këto të drejta do të jenë të vlefshme për një kohëzgjatje prej të paktën 15 vitesh, dhe të përfshijnë, aty ku shikohet e nevojshme për të qenë në linjë me paragrafin e parë, një zgjatje të përshtatshme të periudhës fillestare, prej jo më shumë se të paktën [5] vjet, me kushtet e përcaktuara në këtë paragraf, me qëllim garantimin e parashikueshmërisë rregullore për titullarët e të drejtave për një periudhë prej të paktën 25 vjetësh, përsa i përket kushteve për investime në infrastrukturë, që mbështetet në përdorimin e këtij radio spektri, duke marrë parasysh kërkesat në paragrafin (1).”

### ***Operatori B***

Operatori B është dakord për vlefshërinë 15 vjet.

### **Qëndrimi i AKEP:**

*AKEP, në zbatim të ligjit nr. 9918/2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 72 për “kohëzgjatjen e vlefshmërisë së autorizimit individual” do të aplikojë afat vlefshmërie autorizimi prej 15 vjetësh.*

### **7- Për pyetjen 7 të AKEP:**

*1. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.635, datë 15.07.2015, “Për disa shtesa në Vendimin Nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Rregullave të Zhvillimit të Tenderit Publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar, parashikon përfshirjen edhe të mënyrës së pagesës së autorizimit individual në Dokumentin e Tenderit.*

***Mendimi juaj lidhur me mënyrën e pagesës dhe aplikimin e pagesës me këste në këtë procedurë.***

### ***Operatori A***

Operatori A mbështet përfshirjen e mënyrës së pagesave të autorizimeve individuale në Dokumentin e Tenderit, dhe zbatimin e pagesës me këste.

Duke marrë në konsideratë se spektri 800 MHz aktualisht përdoret nga operatorët e transmetimeve, dhe pavarësisht se ndodhet në proces lirimi, Operatori A kërkon që mënyra e pagesës duhet të marrë parasysh pagesën e përdorimit të licensës vetëm në kohën kur spektri të bëhet i disponueshëm për përdorimin e tij.

### ***Operatori B***

Operatori B ka propozuar si më sipër dhe ka argumentuar për dhënien e këtyre frekuencave pa pagesë. Nëse nuk merren në konsideratë, Operatori B është dakord për aplikimin e pagesës me këste si alternativë duhet të ofrohet patjetër në procedurë.

#### **Qëndrimi i AKEP:**

Duke qenë se palët në parim janë dakord, AKEP vlerëson aplikimin e pagesave me këste sipas përcaktimeve VKM nr.635, datë 15.07.2015, "Për disa shtesa në Vendimin Nr. 1252, datë 10.9.2008, Për Miratimin e Rregullave të Zhvillimit të Tenderit Publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave"

#### **8- Për pyetjen 8 të AKEP:**

**Mendimi juaj për kalendarin e pagesave.**

#### **Operatori A**

Në rast se në Dokumentin e Tenderit do të përfshihet kryerja e pagesave me këste, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.635, datë 15.07.2015, "Për disa shtesa në Vendimin Nr. 1252, datë 10.09.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për Miratimin e Rregullave të Zhvillimit të Tenderit Publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave", kalendarin e pagesave nuk mund të jetë më i gjatë se viti kalendarik dhe kësti i parë nuk mund të jetë më pak se 20% e çmimit të ofertës.

Çdo ofertues duhet të lejohet të dorëzojë propozimin e tij për kalendarin e pagesave.

#### **Operatori B**

Operatori B shprehet se është dakord me pagesën me këste, dhe gjithashtu, në këtë procedurë afati i pagesave të jetë jo më pak se një vit kalendarik, ngjashmërisht me procedimet e mëparshme.

#### **Qëndrimi i AKEP:**

AKEP do të kërkojë aplikimin e kalendarit të pagesës në përputhje me përcaktimet e VKM nr.635, datë 15.07.2015, "Për disa shtesa në Vendimin Nr. 1252, datë 10.9.2008, Për Miratimin e Rregullave të Zhvillimit të Tenderit Publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave"

#### **9- Për pyetjen 9 të AKEP:**

*Nëse do të rezultoni fitues i një të drejtë përdorimi, cila është teknologjia që do të aplikoni për ndërtimin e rrejtit të aksesit?*



## ***Operatori A***

Operatori A do të përdorë teknologjinë LTE në rrjetin e saj të aksesit mbështetur në spektrin 800 MHz. Kjo mund të krijojë një shtresë të veçantë mbi shtresat e tjera të spektrit LTE, siç janë 1800 MHz ose 2600 MHz, ose në disa raste do të zbatohet agregimin e bartësve (carrier aggregation).

## ***Operatori B***

Lidhur me këtë procedurë, Operatori B shprehet se teknologjia që do të përdoret do të jetë FDD për shkak të numrit më të madh të terminaleve që janë në treg për këtë teknologji.

## **Qëndrimi i AKEP:**

*AKEP vlerëson informacionin e sjellë nga palët, në respekt edhe të qëllimit të ligjit nr. 9918/2008 që nëpërmjet parimit të asnjansisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

## ***Argumentat për ndonjë çështje tjetër për t'u marrë në konsideratë:***

## ***Operatori A***

Edhe pse konsultimi publik për brezin 800 MHz filloi, AKEP nuk ka bërë asnjë njoftim zyrtar ku të përcaktojë se kur do të lirohet spektri në gjithë territorin e Shqipërisë.

Operatori A kërkon të dijë datën e saktë kur spektri do të lirohet në gjithë territorin e vendit duke qenë se ky është një informacion i rëndësishëm për përlogaritjen e saktë të vlerës së spektrit.

Procedura e tenderit nuk duhet të fillojë përpara se spektri të jetë liruar në të gjithë territorin e Shqipërisë, në mënyrë që të shmanget situata ku operatorëve të telekomunikacionit u duhet të paguajnë vlerat e ofertave të tyre për të drejtat e përdorimit ndërkohë që spektri nuk është liruar akoma nga operatorët e mediave.

Gjëja më e rëndësishme është qasja e duhur lidhur me politikat për vendosjen e çmimit minimal për spektrin.

Së pari dëshirojmë të theksojmë se shoqëria Operatori A si një nga operatorët e rrjeteve celulare dhe si nga palët e interesuara duhet të ishte përfshirë në të gjitha konsultimet përkatëse gjatë kohës që “Ligji për lirimimin e dividentit dixhital” ishte duke u përgatitur në vitin 2017. E njëjta mundësi duhej t'i jepej të gjithë operatorëve celulare si dhe AKEP. Ne

besojmë që si një kompani që afektohet direkt nga ky ligj duhet të ishim konsultuar në veçanti në lidhje me vlerësimin mbi vlerën minimale të përdorimit të frekuencave në brezin 800 MHz, pasi pritet që ne të paguajmë këtë vlerë, ose një vlerë më të lartë, në procedurën e shitjes së spektrit.

Në këtë mënyrë ne gjendemi përpara një situatë ku vlera minimale është përcaktuar shumë më e lartë se sa pritshmëritë dhe kalkulimi real i vlerës së spektrit në tregun shqiptar të telefonisë së lëvizshme.

Nëse vlera minimale nuk do të ulet, fatkeqësisht ne nuk do të kemi mundësi të marrim pjesë në procedurën e deklaruar për dhënien e frekuencave në brezin 800 MHz.

Sipas Ligjit Nr. 34/2007, datë 30.03.2017, mbi Lirimin e Frekuencave të Dividentit Dixhital, neni 5 lidhur me Kompensimin Financiar të operatorëve të mediave, parashikohet se kompesimi financiar, që do të jetë të paktën 5 000 000 (pesë milion) Euro, do të sigurohet nga të ardhurat e marra për lëshimin e autorizimeve individuale për kompanitë e komunikimeve celulare, për përdorimin e frekuencave të Dividentit Digital 1. Kjo nuk të kalojë masën 10% të vlerës së pagueshme për autorizimin individual. Fakti që komensimi financiar i parashikuar nga qeveria për operatorët e mediave, i cili nuk i tejkalon 10% të vlerës së pagueshme për autorizimin individual, çon në mendimin se vlera e pritur për ofertën e spektrit 800 MHz do të jenë të paktën 50 000 000 Euro.

Vlera e pritur prej 50 milion Euro, e kushtëzuar nga vendimi i qeverisë për kompesuar operatorët e mediave është e papranueshme për Operatorin A, si bazë për përfitimin e niveleve minimale të ofertimit për spektrin 800 MHz.

Siç kemi treguar dhe në përgjigjen tonë ndaj pyetjes 2 më lart, Operatori A argumenton me forcë se është tejet e rëndësishme që vlera ekonomike e spektrit dhe nivelet minimale të ofertave për këtë spektër të jenë përlllogaritur duke u bazuar në kushtet ekonomike aktuale të telefonisë celulare dhe fitimet që një operator rrjeti dhe ofruer shërbimi mund të marrë nga ofrimi i shërbimeve me vlerë të shtuar dhe aplikacioneve, duke përdorur ekskluzivisht këto frekuenca. Përndryshe, investitorët mund të mos kenë mundësi të japin oferta të konsiderueshme për spektrin.

Vlera e spektrit nuk mund të përfitohet nga çdo shumë parash që qeverisë i duhet për të kompesuar operatorët e mediave.

Operatori A, kërkon që qeveria ta ndryshojë këtë vendim dhe të trajtojë operatorët e mediave siç trajton operatorët e telekomunikacionit, të cilët i paguajnë AKEP dhe shtetit tarifa për përdorimin e frekuencave, sipas kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi. Operatori A konsideron të rëndësishëm publikimin e një vendimi nga Qeveria për vendosjen e një çmimi minimal në zhvillimin e tenderit publik të ardhshëm, bazuar në kushtet ekonomike aktuale të vendit dhe vlerën e tregut celular.

Operatori A thekson faktin se është shumë e rëndësishme që Qeveria Shqiptare të përcaktojë urgjentisht termat për disponueshmërinë e brezit 800 MHz, duke qënë se ai është akoma në përdorim nga operatorët e transmetimeve televiziv, në mënyrë që të krijojë sigurinë e nevojshme për planet e investimit të operatorëve të komunikimeve elektronike për këtë qëllim.

### ***Operatori B.***

Operatori B shprehet se kërkon që të garantohet që përpara se të fillojnë procedurat e alokimit të këtij brezi frekuencash për operatorët e komunikimeve elektronike, banda respektive të jetë e lirë nga përdorimi i saj nga kushdo tjetër. Kjo për arsye, se çdo angazhim në ideim, projektim, planifikim shkakton një kosto të pajustificueshme në kushtet që nuk ka garanci që kjo bandë frekuencash do të jetë e disponueshme dhe jo e zënë. Operatori B shprehet se është në dijeni që brezi nuk është ende plotësisht i lirë dhe madje edhe procesi i lirimit të këtij brezi është akoma i pamaturuar.

### ***Operatori C***

Operatori C shprehet se, në vijim të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 10, datë 15.2.2018 “Mbi “Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz)” mirëpret çdo nismë të Autoritetit Rregullator Kombëtar për caktimin e frekuencave duke qenë se i shërben objektivit të investimeve të reja në teknologjitë inovative dhe përmirëson cilësinë e shërbimeve të ofruara konsumatorëve.

Operatori C për shkak të nevojave të tij zhvillimore, ka treguar gjithmonë interes të madh ndaj qëndrimit të Qeverisë Shqiptare për dividetit dixhital (*Operatori C përmend aktet ligjore e nëligjore të miratuara për këtë qëllim*).

Operatori C shprehet se, nga momenti që ka hyrë në tregun shqiptar, ka pozicionuar veten si një investitor të vazhdueshëm dhe pioner në zhvillimin e teknologjive të reja.

Përveç kësaj, Operatori C shprehet se, ka treguar gjithnjë shqetësim në lidhje me këtë proces të caktuar të pastrimit të spektrit të nisur nga AKEP, AMA dhe qeveria shqiptare për të siguruar një spektër pa interferenca që mund të shkaktohen nga kanalet televizive që transmetojnë sinjale analoge. Megjithatë, ky proces nuk ka perfunduar ende në disa qytete si Fieri, Lushnja, Divjaka, etj, ku procesi i pastrimit sapo ka nisur. Kjo do të ishte në çdo rast një kërkesë paraprake përpara se të zbatohet alokimi i spektrit. Përfitimet e përdorimit të këtij brezi janë të ndryshme dhe multidimensionale.

Operatori C shprehet se, AKEP në dokumentin e tij, ka përmendur se, në Evropë brezi 800 MHz ka më shumë se 5 vjet që përdoret edhe për shërbimet celulare. Dhënia e këtij brezi ka ardhur jo vetëm si nevojë për shkak të rritjes së trafikut të të dhënave, por edhe duke konsideruar ndikimin e tij të drejtpërdrejtë në nivelin ekonomik të vendit (GDP). Per sa u perket perfitimeve te drejtperdrejta te konsumatorët nga përdorimi i këtij brezi, elementi kryesor është zhvillimi i "Internet of Things -IoT- qe po zhvillohet graduallsht ne nivel global.

Shërbimet dhe aplikacionet e ndryshme të rasteve të përdoruesve të IoT janë klasifikuar në katër kategoritë e mëposhtme:

1. IoT Public (aplikacione që i shërbejnë publikut të gjerë).
2. IoT Industry (aplikacione që ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit të përgjithshëm të ndërmarrjes dhe atë industrial).
3. IoT Appliance (shtëpi inteligjente).
4. IoT Personal.

Megjithëse mundësia që ofron IoT konsiderohet nga industria si e rëndësishme dhe multidimensionale në terma afatgjatë (5-10 vitet e ardhshëm), rastet e biznesit aktualë nuk

janë akoma plotësisht të qarta dhe kërkojnë investim paraprak në infrastrukturë me një përfitim financiar të kufizuar afatshkurtër.

Sa më lart investimi i nevojshëm për shfrytëzimin e brezit të ngushtë si 800 MHz arrin në XXXXX euro. Shuma për blerjen e spektrit është vetëm pjesa fillestare e investimit dhe duke pasur parasysh çmimet referencë evropiane për 800 MHz, ajo varion nga XXXXX milionë euro për 2x10 MHz. Përveç kësaj shume, zhvillimi i teknologjive të reja për të mbështetur industrinë si bujqësia, kujdesi shëndetësor, prodhimi, energjitikës dhe shërbimeve, etj. kanë nevojë për një investim shtesë prej më tepër se XXXXX euro.

Në përfundim, Operatori C shprehet se, duke pasur parasysh nivelin e investimit të kërkuar paraprak (*spektër dhe infrastrukturë*) si dhe mjedisin aktual rregullator armiqësor dhe të pasigurt (*ku po zbatohen masa rregullatore të rrepta dhe joproportionale në treg, duke shtrembëruar konkurrencën, në kundërshtim me kuadrin rregullator evropian*), nuk mund të marrë në konsideratë pjesëmarrjen në këtë proces tenderi për spektrin.

### **Qëndrimi i AKEP:**

I. AKEP në zbatim të Ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, ka zhvilluar analizat e tregjeve përkatëse dhe i gjen të pambështetura komentet e sipërmarrësit Operatori C.

Si organ rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, AKEP po vepron në përputhje me objektivat e përcaktuar në nenin 7, të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera rregullatore në fuqi, në funksion të nxitjes së investimeve në sektorin e komunikimeve elektronike.

II. Në lidhje me çështjet e ngritura nga operatorët për këtë pikë, informon se në AKEP janë depozituar:

1. Shkresa e Autoritetit të Mediave Audiovizive me nr. 674 Prot. datë 7.2.2018 “Për lirimin e brezit të frekuencave të Dixhital – Dividentit (DD1), me anë të së cilës informohemi se, citojmë:

- *Brezi i frekuencave të Dixhital – Dividentit (DD1), është liruar plotësisht nga transmetimet audiovizive.*
- *Ky brez është i lirë të përdoret nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për rrjetet e komunikimeve mobile.*

2. Shkresa e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 3053/1Prot. datë 15.02.2018 “Për fillimin e procesit të këshillimit publik për frekuencat në brezin 800MHz (792-860MHz), subjekt i mundshëm i të drejtave të kufizuara”, me anë të së cilës Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, i kërkohet:

- *Fillimi i procesit të këshillimit publik me palët e interesuara për përdorimin e këtij brezi të frekuencave, subjekt i mundshëm i të drejtave të kufizuara.*

**Në përfundim të këtij procesi, AKEP, falënderon, palët për kontributin e sjellë në komentet e tyre për këtë proces këshillimi!**